



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 528/3 prot.

Tiranë, më 18.11.2020

VENDIM
Nr.151, datë 18.11.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 26, DATË 19.4.2019

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 26, datë 19.4.2019, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*,

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr. 96, datë 03.12.2018, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimi e shërbimit civil, në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër dhe Fushë - Krujë”*, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në institucionin Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë - Krujë.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin Paralajmërues Nr. 26, datë 19.4.2019, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë - Krujë, me shkresën nr. 408/1 prot., datë 8.7.2020, *“Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve”*, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues dhe në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë - Krujë, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim. Konkretisht:

1. Departamenti i Administratës Publike, me aktet nr. 7733/1 prot., datë 16.1.2020 dhe 7733/2 prot., datë 16.1.2020, ka deklaruar ***** dhe ***** nëpunës civil në pozicionin “*Specialist*” me grada/tituj shkencorë.
2. Formularët e përshkrimit të punës janë hartuar nga institucioni dhe janë dërguar pranë ministrisë së linjës, për t’u përcjellë më pas pranë Departamentit të Administratës Publike për miratim.
3. Njësia përgjegjëse ka marrë të gjitha masat duke plotësuar mangësitë e konstatuara në dosjet individuale të personelit për secilin nëpunës dhe duke i bërë pjesë të këtyre dosjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 26, datë 19.4.2019, të Komisionerit, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë*”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë - Krujë, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 26, datë 19.4.2019.
3. Për këtë vendim të njoftohet Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë - Krujë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe Departamenti i Administratës Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha